



Me
Dana 03-01-2019

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:059621
Datë: 20.11.2018
Numri i dokumentit: 00172435

P.nr.912/17

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I
PERGJITHSHEM DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje
nga gjyqtarja, Hysnije Gashi, me zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të
pandehurit, [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale
vjedhja e rënde nga neni 327 par.1 nenpar. 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë
Themelore në Ferizaj PP.nr.2920-1/14 te datës 14.04.2017 në praninë e përfaqësuesit të akuzës
- Prokurorit të shtetit, Avdullah Abedini, të pandehurit, [REDACTED], mbrojtësi ti tij me
autorizim Av. [REDACTED], te dëmtuarit [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më
dt.01.11.2018, morri dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

[REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna Ferizaj, i
lindur me datë [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë
[REDACTED] i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas e Republikës së
Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30(tridhjetë)€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.2920-1/14 te datës 14.04.2017 e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale vjedhja e rënde nga neni 327 par. 1 nenpar. 1.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor më dt. 01.11.2018 në të cilin Prokurori i Shtetit, Avdullah Abedini, në tërësi mbeti pranë aktakuzës, duke i propozuar gjykatës që te pandehurin [REDAKTUAR] ta shpallë fajtor dhe të i shqiptoi sanksion penal sipas ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR] ne shqyrtimin gjyqësor te datës 01.11.2018, me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së ka deklaruar se e pranon fajësinë për te gjitha pikat e aktakuzës, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të kësaj natyre, i premtton gjykatës se te dëmtuarit do te ia kompenson demin e shkaktuar dhe i propozon gjykatës që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri [REDAKTUAR] e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, te behet ne fotografit, kopja e librezës se automjetit te cilat gjenden ne shkresat e lendes.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale veprën penale vjedhja e rënde në nga neni 327 par 1 nën par 1.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata, ka konstatuar se ekzistojnë rrethanat lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me dënimin më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit kështu që në kuptim të nenit 75,76 të KPRK-së aplikoi dispozitat për zbutjen e dënimit, Gjykata bëri zbutjen e dënimit duke marrë rrethanat lehtësuese, pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, premtimi se do te ia kthej dëmin e shkaktuar, kërkim falja publike , sjellja e tij pas kryerjes së vepres penale ., i gjendjes se dobet ekonomike, si rrethane rënduese, vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet euro) në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Numri i lëndës: 2018:059621
Datë: 20.11.2018
Numri i dokumentit: 00172435

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM –
DIVIZIONI PENAL**

P.nr.912/17 të dt. 07.11.2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtarja,
Hysnije Gashi


KËSHILLA JURIDIKE kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit Gjykatës së APELIT në Prishtinë përmes kësaj gjykate.